

VENDIM
Nr.843, datë 21.10.2010

PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NË BUXHETIN E VITIT 2010, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rishpërndarje fondesh, ndërmjet programeve, në buxhetin e vitit 2010, miratuar për Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, si më poshtë vijon:

a) Në programin e “Artit dhe kulturës” të shtohet fondi, me vlerë 5 700 000 (pesë milionë e shtatëqind mijë) lekë, për paga e sigurime shoqërore.

b) Në programin e “Planifikim-menaxhimit” të shtohet fondi, me vlerë 1 000 000 (një milion) lekë, për paga e sigurime shoqërore.

c) Në programin e “Trashëgimisë kulturore” të pakësohet fondi, me vlerë 4 800 000 (katër milionë e tetëqind mijë) lekë, për paga e sigurime shoqërore.

ç) Në programin e “Zhvillimit të sportit” të pakësohet fondi, me vlerë 1 900 000 (një milion e nëntëqind mijë) lekë, për paga e sigurime shoqërore.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha